

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-105/12

**Prishtinë,
5 mars 2013**

Në çështjen juridike të:

S. H.

C.

G.

Pala ankuese

kundër.

S. P. S.

D

M.

S.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, duke vendosur me ankesat kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/133/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA34467), të datës 7 dhjetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur më 5 mars 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/13/2011, i datës 7 dhjetor 2011, sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34467, dhe hedhet poshtë kërkesa pasi që lënda nuk është nën kompetencën e KKPK-së.
- 2- Obligohet pala përgjegjëse në ankesë që t'i paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 45 (dyzet e pesë) brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 15 nëntor 2007, S. P. S. paraqiti një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin e një prone që ndodhet në Cernicë, Gjilan, ngastra nr. 2682, një arë e klasës 5 me sipërfaqe prej 10 ari dhe 2 m². Ai ka sqaruar se i ati i tij i ndjerë P. K. S. kishte qenë pronar i kësaj ngastra dhe se ajo ishte humbur më 19 qershor 1999 si pasojë e rrethanave gjatë periudhës 1998/1999 në Kosovë. Lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA34467.

Paraqitësi i kërkesës dorëzoi në AKP fletën poseduese nr. 132 të datës 22 prill 1984, e cila konstatonte se ngastra kontestuese ishte e regjistruar në emër të P. K. S..

AKP-ja gjeti Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme (UL-70403062-00132), sipas të cilës ngastra ishte e regjistruar në emër të S. P. S., paraqitësi i kërkesës.

Në vitin 2008, AKP bëri njoftimin e kërkesës duke vendosur një njoftim në vendin kur pretendohet se ndodhet ngastra. Në vitin 2010, AKP përsëri bëri njoftimin e kërkesës, këtë herë duke e publikuar kërkesën në Gazetën e Njoftimeve Nr.6 si dhe në Buletinin e zyrës për çështje pronësore të UNHCR-së. Gazeta dhe Lista u lanë tek një pronar i një shitoreje në Cernicë, i cili pranoi që t'i vejë ato në dispozicion të palëve të interesuara. Publikimet u lanë po ashtu në hyrje dhe dalje të fshatit Cernicë, si dhe në disa zyra në Gjilan.

Meqë askush nuk u përgjigj, kërkesa u trajtua si e pakontestuar dhe KKPK-ja me vendimin e vet KKPK/D/A/133/2011, të datës 7 dhjetor 2011 aprovoi kërkesën, duke vendosur që paraqitësi i kërkesës, S. P. S. kishte dëshmuar se S. P S ishte pronari i ngastrës dhe se kishte të drejtë ta posedonte.

Më 16 gusht 2012, S. H. (këtej e tutje: pala ankuese) paraqiti ankesë, duke theksuar se ai e kishte blerë ngastrën më 17 qershor 2003 nga S. P. S.. Ai dorëzoi në AKP një kontratë përkatëse me shkrim.

Ankesa i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (këtej e tutje: pala përgjegjëse në ankesë) më 19 nëntor 2011.

Më 27 dhjetor 2011, pala përgjegjëse në ankesë kërkoi nga AKP-ja që ta mbyll kërkesën KPA34467. Ai nënshkroi një formular të siguar nga UNHCR ku shkruante si në vijim:

“Kërkesë për ta mbyllur kërkesën e vendosur nga AKP-ja KPA34467

Unë, paraqitësi i kërkesës, S. S.

Përmes kësaj konfirmoj kërkesën për mbylljen e kërkesës së dorëzuar të AKP-së për pronën e lartcekur. E kuptoj se AKP-ja do ta mbyll këtë lëndë në lidhje me pronën e lartcekur pa ndonjë veprim të mëtejshëm. Duke nënshkruar këtë formular, Paraqitësi i kërkesës apo personi i autorizuar ka hequr dorë përgjithmonë nga çfarëdo kërkesë drejtuar AKP-së. Unë kam bashkëngjitur një kopje të letërnjoftimit tim (dhe një autorizim me shkrim të paraqitësit të kërkesës nëse është e zbatueshme).

Paraqitësi i kërkesës apo përfaqësuesi ka këtë arsye për ta mbyllur rastin:

Prona i është shitur apo dhënë një personi të tretë.”

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme ndonëse pala ankuese nuk ka qenë palë në procedurën para KKPK-së. Kjo rrethanë nuk mund të shkojë në dëm të palës ankuese pasi që në fakt ai nuk kishte qenë i njoftuar për kërkesën si duhet. Njoftimi është bërë përmes publikimit të kërkesës në Gazetën e Njoftimeve të AKP-së dhe në Buletinin e UNHCR-së. Kjo, megjithatë, përbën “përpjekje të arsyeshme” për ta bërë njoftimin për kërkesën sikurse parashihet me nenin 10.1 të rregullores vetëm në raste të veçanta. Një përjashtim i tillë nuk mund të gjendet në këtë lëndë. Pasi që gjykata nuk mund ta përjashtojë faktin se pala ankuese nuk ka qenë në dijeni për kërkesën, ai duhet të pranohet si palë në procedurë, ankesa e tij është e pranueshme.

Në shkresën e tij për mbylljen e kërkesës së vendosur nga AKP-ja, paraqitësi i kërkesës në mënyrë të përhershme ka hequr dorë nga çfarëdo dhe të gjitha kërkesat e adresuara AKP-ës. Kjo kërkesë duhet të

konsiderohet si heqje dorë nga kërkesa e paraqitur (Neni 149 i Ligjit të Procedurës Kontestimore), e cila është e mundur jo vetëm para KKPK-ës, por edhe në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-ës (neni 193 i Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Pas heqjes dorë nga kërkesa, pa ndonjë procedurë të mëtejme gjykata merr aktgjykim me të cilin refuzon kërkesën nga e cila paraqitësi i kërkesës ka hequr dorë. Kjo, megjithatë, ka si parakusht rregullin e përgjithshëm se lënda duhet të jetë nën kompetencën e gjykatës. Mirëpo, kjo lëndë nuk është nën kompetencën e KKPK-së/Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Ndonëse KKPK-ja si organ gjysmë-gjyqësor duke vendosur mbi meritat e kërkesës tashmë ka pranuar kompetencën e vet, gjykata *ex officio* vlerëson nëse lënda është nën kompetencën e vet (neni 195.1 b) i Ligjit të Procedurës Kontestimore).

Prandaj ky vendim i KKPK-së, për aq sa është e ankimuar, është dashur të anulohet dhe kërkesa të hedhet poshtë (neni 11.4 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), e jo të refuzohet.

Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm të drejtën pronësore por edhe se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Megjithatë, në këtë rast, pala përgjegjëse në ankesë pranon se kjo ngastër ishte “shitur apo dhënë një personi të tretë”.

Prandaj, humbja e pronës nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999 në Kosovë.

Si rrjedhojë, vendimi i KKPK-së lidhur me kërkesën është dashur të anulohet dhe kërkesa të hidhet poshtë pasi që nuk është nën kompetencën e KKPK-së dhe Gjykatës.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit..

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit, meqë vlera e ngastrës kontestuese mund të vlerësohet në më pak se € 1.000 (10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2): € 15.

Këto shpenzime gjyqësore duhet të paguhen nga pala përgjegjëse në ankesë që ka paraqitur një ankesë të papranueshme. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, kur një person me vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit është i obliguar të paguajë një taksë, afati për pagesë nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendosi se afati këtu është 90 (nëntëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it